



UDHËZUES TEKNIK

Si të mbrohemi dhe të parandalojmë zjarret!

Ky udhëzues i adresohet shkollave, çerdheve, familjeve dhe publikut të gjerë.



BASHKIA VLORE

Ky udhëzues është përgatitur nga Bashkia Vlorë dhe Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë.

Falenderojmë për kontributin:

Jeton Puka; Robert Murataj; Artur Lazaj;
Nertila Përrallaj; Kastriot Merkaj; Melaize
Selami; Kanan Shakaj; Elton Qëndro;

Fotot:

Qendra e Informacionit Aarhus (faqe 1);

Pasqyra e udhëzuesit

Hyrje	4
Çfarë është zjarri:.....	5
Si të parandalojmë rënien e zjarrit.....	5
Si të veprojmë në raste kur konstatojmë një zjarr?	6
Përgatitja për raste emergjencash në shkollë:.....	7

Hyrje

Shqipëria, ashtu si edhe vende të tjera të rajonit apo edhe më gjerë, është një vend i cili ka përjetuar eksperiencë dhe fatkeqësi natyrore dhe industriale, të shkaktuara nga fenomene natyrore ose edhe nga dora e njeriut. Këto fenomene janë nga më të ndryshmet duke filluar nga: përmbytjet, tërmetet, rrëshqitjet e tokës, epidemitë, zjarret në ndërtesa, banesa, pyje etj.

Në bazë të klasifikimit të riskut botëror për vitin 2014, Shqipëria renditet e 37-ta nga 171 vende të botës, për rrezikun ndaj fatkeqësive natyrore.

Shpesh fatkeqësitë natyrore janë të paparashikueshme dhe të paevitueshme, megjithatë, nëse merren masat e duhura si nga ana teknike ashtu dhe duke rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin e shtresave të ndryshme të shoqërisë, është e mundur që shumica e fatkeqësive natyrore të parandalohen e mbi të gjitha të minimizohen dëmet e shkaktuara prej tyre.

Përgatitja për përballimin e emergjencave natyrore si dhe marrja e masave për parandalimin dhe zbutjen e efekteve të dëmeve që ato shkaktojnë, parashikohet edhe në legjislacionin shqiptar në ligjin Nr.8756, datë 26.3.2001 PËR EMERGJENCAT CIVILE I përditesuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009.

Kjo broshurë informuese ka për qëllim që t'iu rekomandojë institucioneve publike vendim-marrese, një sërë masash të nevojshme për t'u zbatuar me qëllim shmangjen dhe parandalimin e zjarreve dhe evitimin e zjarrvënieve të qëllimshme apo të rastësishme.

Çfarë është zjarri:

Zjarri është fenomeni i djegies që shoqërohet me çlirimin e nxehtësisë së lartë, flakë përcëlluese, dritë dhe tym. Që zjarri të ekzistojë nevojiten tre elementë bazë: lënda djegëse, oksigjeni dhe ndezësi. Dy të parat, dmth lënda djegëse dhe oksigjeni, gjenden lehtë, pothuaj kudo, ajo që eviton ose ndihmon në fillimin e një zjarri është ndezësi, në rastin tonë një shkrepse, çakmak, bisht cigareje etj, të cilat zakonisht janë pronë e njeriut, pra janë në dorën tonë dhe vetëm ne mund ta ndezim një zjarr.

Sigurisht që ka edhe mënyra të tjera të ndezjes së një zjarri siç mund të jetë fenomeni i rrufeve ose shpërthimet e ndryshme që ndodhin nga veprimtaria industriale e njeriut, por elementi klasik i ndezjes së një zjarri në një ambient, pyll apo banesë mbetet faktori njeri.

Në takimet e organizuara nga Organizata jonë: Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë përgjatë periudhës Shkurt – Qershor 2016 me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, grupe interesi dhe nxënës e studentë, është përmendur fakti se në shumicën e rasteve të zjarrvënies, faktori njeri është decisiv dhe në 95% të rasteve zjarret shkaktohen ose qëllimisht ose nga pakujdesia e njeriut.

Si të parandalojmë rënien e zjarrit

Për të parandaluar zjarret është shumë e rëndësishme që të njihemi dhe familjarizohemi me disa rregulla të thjeshta, të cilat nëse zbatohen me rigorozitet, bëjnë të mundur evitimin e zjarrvënies në ambientin ku ne jetojmë, punojmë dhe kryejmë aktivitetin tonë jetësor.

Këto masa të thjeshta përfshijnë:

- Mos hidhni bishtat e cigareve apo shkrepset e pafikura në tokë, pasi ato mund të shkaktojnë zjarr;
- Mos ndizni zjarr në pyll! Është e ndaluar me ligj dhe shumë e rrezikshme;
- Mos hidhni mbeturina në pyje; ato mund të përmbajnë lëndë djegëse dhe mund të shkaktojnë zjarre;
- Mos digjni sende pa marrë masat e duhura mbrojtëse ndaj zjarrit; situata mund t'ju dalë jashtë kontrollit;
- Mos lini qirinjtë të ndezur pa mbikëqyrje tuaj dhe mos i vendosni pranë sendeve që mund të marrin zjarr;

- Mos lini tenxheret dhe tiganët mbi soba/furnela të ndezuara pa mbikëqyrje;
- Kontrolloni vazhdimisht instalimet elektrike dhe pajisjet për çarje apo zhveshje të mundshme;
- Mos mbingarkoni rrjetin elektrik dhe prizat duke ndezur në të njëjtën kohë pajisje si sobë, lavatriçe, hekur etj;
- Përdorni bombola të sigurta, të cilat kanë të shënuar parametrat teknike të kontrollit;
- Kontrolloni teknikisht dhe pastroni pajisjet me gaz çdo vit.

Megjithatë, sado që ne të veprojmë me rigorozitet dhe t'i zbatojmë me përpikmëri të gjitha rregullat dhe këshillat e mësipërme, zjarri mund të ndodhë dhe ne duhe të jemi të përgatitur që të përballemi me këtë fenomen, për të shmangur dëmet që ai shkakton si në materiale ashtu dhe në njerëz.

Zjarri është një fenomen i cili edhe pse shumë i rëndësishëm në aktivitetet dhe jetën tonë të përditshme, mund të bëhet shumë i rrezikshëm nëse del jashtë kontrollit, qoftë në një banesë, ndërtesë ashtu edhe në një hapësirë me pyje, shkurre apo në depozitat e lëndëve të djegshme, karburant, gaz metan.

Si të veprojmë në raste kur konstatojmë një zjarr?

Kur ndjeni erë të rëndë, konstatooni tym apo shihni rrjedhje gazi, reagoni menjëherë dhe merrni masat e mëposhtme:

- Bëni njoftimin e menjëhershëm të të gjithë pjesëtarëve të familjes;
- Shkëpusni energjinë elektrike në shtëpinë tuaj duke ulur siguresën/automatin e dritave;
- Mbyllni menjëherë valvulën kryesore të gazit, nëse është e mundur;
- Hapini të gjitha dyert dhe dritaret për të bërë të mundur qarkullimin e ajrit.
- Së bashku me pjesëtarët e tjerë të familjes dilni menjëherë jashtë ambienteve të shtëpisë/banesës;
- Nëse shikoni zjarr ose tym diku telefononi menjëherë zjarrëfikset në numrin 128 (shërbim falas) dhe jepni informacion sa më të saktë për vendndodhjen e objektit, ndërtesës apo zonës ku ka rënë zjarri.
- Mos qëndroni afër zjarrit dhe sidomos në vende ku fryn erë sepse flakët mund të përhapen shpejt në drejtimin tuaj;
- Shtrihuni përtokë në një vend ku nuk ka sende që mund të marrin flakë;

- Nëse ju marrin flakë rrobat që keni veshur, shtrihuni menjëherë përtokë dhe rrokullisuni për të fikur flakët. Mos vraponi sepse oksigjeni në ajër i shton flakët;
- Mos përdorni ashensorin pasi rrezikon të bllokohet, por përdorni shkallët;
- Përdorni daljet e emergjencës aty ku është e mundur;
- Mos përhapni panik dhe mos shtyni të tjerët gjatë daljes;
- Telefononi Ambulancën në numrin 127 (shërbim falas) nëse ndiheni keq nga ana shëndetësore.

Përgatitja për raste emergjencash në shkollë:

Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë, në bashkëpunim me Dretjorinë e Zjarrfikses në Bashkinë Vlorë, gjatë periudhës Mars – Qershor 2016, organizuan 14 sesione edukuese dhe informuese me nxënës, mësues dhe stafin e shkollave publike dhe jo-publike në Bashkinë Vlorë për masat parandaluese që duhet të marrë çdokush në rast emergjece civile e sidomos në raste zjarri në ambientet e shkollave.

Në këto sesione u diskutua për infrastrukturën që duhe të ketë çdo shkollë me qëllim që të jenë të përgatitur për çdo të papritur që mund të ndodhë në shkolla dhe të mos ketë pasoja negative tek nxënësit apo mësuesit e shkollave.

Duhet përmendur fakti se në shumë raste ekziston një infrastrukturë e kënaqshme në shkollat e Bashkisë Vlorë për të përballur fenomene natyrore si zjarri, tërmetet etj, megjithatë ka vend për përmirësime në të gjitha ndërtesat publike që përdoren për shkolla publike ose jo-publike.


Disa nga rekomandimet që duhen marrë parasysh nga autoritetet përkatëse për të përmirësuar infrastrukturën e ndërtesave të shkollave publike dhe jo-publike për të evituar dëmet që mund të shkaktojnë fatkeqsitë natyrore si zjarri dhe tërmetet janë:

- Stafi pedagogjik i shkollave duhet të ketë një plan veprimi të detajuar në rast të emergjencave natyrore, të jetë i publikuar gjithashtu në çdo korridor në çdo kat të ndërtesave;
- Çdo shkollë duhet të ketë një plan paraprak evakuimi dhe një vend grumbullimi për nxënësit dhe mësuesit në rast të një emergjence civile;

Ndërtesat e shkollave duhet të ketë një strukturë të qëndrueshme dhe të përshtatur me elementët e nevojshme për evakuim si:

- Shkallëte e emergjencës;
- Vijë fosforeshente në çdo kat me shigjetë në drejtim të daljeve të emergjencës;
- Dalje emergjence;
- Të mos ketë zgara hekuri në dritaret e të gjitha kateve të ndërtesës së shkollave;
- Dyert e shkollave të hapen me drejtim nga jashtë për të mos u bllokur nga nxënësit në rast të marshimit të tyre jashtë kur ka emergjencë;
- Çdo shkollë duhet të jetë e pajisur me fikëse zjarri dhe çdo nxënës duhet të dijë si të përdorë fikësen e zjarrit për të ndihmuar të tjerët në çdo rast emergjence;

Ky udhëzues është përgatitur nga Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë dhe Bashkia Vlorë në kuadrin e projektit rajonal “Reduktimi i Rrezikut të Katastrofave dhe Siguria në hapësirën e OSBE-së”. Në Shqipëri projekti është i zbatuar nga Prezenca në Shqipëri. Projekti zbatohet me mbështetjen financiare të Zvicrës.



Mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë medeomos mendimet e OSBE-së dhe donatorit të tyre.